

**REKOMANDIMI NR. 87/567/KES, NË LIDHJE ME TRAJNIMIN
PROFESIONAL TË GRAVE**

(24 nëntor 1987)

Komisioni i Komuniteteve Evropiane,

Duke pasur parasysh Traktatin themelues të Komunitetit Ekonomik Evropian dhe kryefjalën e dytë të nenit 155 të tij,

Duke pasur parasysh që neni 4 të Direktivës 76/207/KES, të datës nëntë shkurt njëmijë e nëntëqind e shtatëdhjetë e gjashtë, në lidhje me zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë për gratë dhe burrat për sa i përket të drejtës për punësim, trajnim dhe promovim profesional, dhe kushte pune, deklaron që shtetet anëtare do të sigurojnë aplikimin e parimit të trajtimit të barabartë në lidhje me mundësinë e trajnimit dhe ritrajnimit profesional të të gjitha llojeve dhe niveleve;

Duke pasur parasysh që komunikimi i Komisionit me Këshillin transmetuar më njëzet dhjetor njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë, në lidhje me 'Mundësitë e Barabarta për Gratë – Programi Afat-Mesëm i Komunitetit 1986 deri 1990', përfshinte arsimimin dhe trajnimin si një prej shtatë fushat e veprimit të përcaktuara në të dhe theksonte se Komisioni do t'i propozojë Komitetit orientimet në lidhje me trajnimin profesional për gratë;

Duke pasur parasysh që Rezoluta e Dytë e Këshillit, e datës njëzet e katër korrik njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë, në lidhje me nxitjen e mundësive të barabarta për gratë mbështeste parimet e gjera të komunikimit të Komisionit që përmendet më lart dhe mbështeti objektivat e programit për realizimin në praktikë të mundësive të barabarta në jetën ekonomike, sociale dhe kulturore;

Duke pasur parasysh që Rezoluta e Dytë e Këshillit i bëri gjithashtu thirrje shteteve anëtare që të ndër marrin veprime të përshtatshme bazuar, ndër të tjera, në komunikimin e Komisionit;

Duke pasur parasysh që Vendimi i Këshillit 86/365/KES, i datës njëzet e katër korrik njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e gjashtë, i cili miratoi programin e bashkëpunimit ndërmjet universiteteve dhe ndërmarrjeve në lidhje me trajnimin në fushën e teknologjisë (COMETT), Vendimi i Këshillit 87/327/KES, i datës pesëmbëdhjetë qershor njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e shtatë, i cili miratoi Skemën e Aksionit Evropian për Lëvizjen e Studentëve të Universitetit (ERAZMUS), Rezolutën e takimit të Këshillit dhe Ministrave të Arsimit brenda Këshillit, të datës dymbëdhjetë korrik njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e dy, lidhur me masat që do të merren për të përmirësuar përgatitjen e të rinjve për punë dhe për të lehtësuar tranzicionin e tyre nga arsimi në jetën e punës, Rezolutën e takimit të Këshillit dhe Ministrave të Arsimit brenda Këshillit, të datës tre qershor njëmijë e nëntëqind e tetëdhjetë e pesë, që përmban një program veprimi në lidhje me mundësitë e barabarta për vajzat dhe djemtë në arsim, propozimet për marrjen e një vendimi të Këshillit që të miratojë një program veprimi për trajnimin dhe përgatitjen e të rinjve për jetën në moshë madhore dhe atë të punës, dhe Komunikatën e Komisionit në lidhje me

trajnimin e të rriturve nëpër kompani, kanë nënvizuar të gjitha rëndësinë që duhet t'i jepet mundësive të barabarta;

Duke pasur parasysh që Parlamenti Evropian në disa raste ka theksuar nevojën për një politikë të plotë në shkallë të gjerë në fushën e mundësive të barabarta për gratë dhe ka stimuluar nxitjen e trajnimit të përshtatshëm profesional për gratë;

Duke pasur parasysh që nevoja për marrjen e masave për trajnim profesional me objektiv të përcaktuar mirë ka dalë në pah për faktin se kriza strukturore në tregun e punës dhe futja në përdorim e teknologjive të reja kanë cenuar seriozisht perspektivat për punësim të grave dhe duke pasur parasysh që tendenca demografike dhe ndryshimet ekonomike dhe sociale kërkojnë që aftësitë e të gjithë punonjësve të jenë të harmonizuara amë pranë kërkesave;

Duke pasur parasysh që kjo situatë ka sjellë zhvillimin në shtetet anëtare të iniciativave të ndryshme që kanë si synim nxitjen e aftësive më të përshtatshme për gratë, por duke pasur parasysh që masat e përfshira kanë mbetur shpesh të kufizuara;

Duke pasur parasysh që janë ndërmarrë gjithashtu një sërë masash në nivel Komuniteti dhe duke pasur parasysh që Fondi Social Evropian kontribuon në financimin e operacioneve të trajnimit profesional;

Duke pasur parasysh që është i rëndësishëm, për pasojë, përcaktimi i orientimeve për ndërmarrjen e një numri veprimesh tërësore specifike në shumë fusha me qëllim që të zhvillohet një trajnim profesional i përshtatshëm për gratë,

Rekomandon sa më poshtë vijon:

Neni 1

Rekomandohet që shtetet anëtare duhet të miratojnë një politikë që ka si synim inkurajimin e pjesëmarrjes së të rinjve dhe të rriturve në skemat e trajnimit, veçanërisht ato që kanë lidhje me punësimin në të ardhmen, dhe duhet të zhvillojnë masa specifike, veçanërisht përsa i përket trajnimit, për vende pune ku gratë janë të përfaqësuara ulët.

Neni 2

Rekomandohet që shtetet anëtare duhet të paraqesin, vazhdojnë dhe inkurajojnë masa aktive që kanë për synim:

a. të integrojnë trajnimin e grave brenda një procesi më të gjerë bashkëpunimi ndërmjet të gjitha palëve të interesuara: autoriteteve dhe organizatave arsimore, shkollës dhe drejtimit profesional, të dy palëve të industrisë, organizatave trajnuese, kreditorëve të kapitalit, autoriteteve qendrore dhe/ose rajonale dhe/ose lokale, organizatave për mundësitë e barabarta, sipërmarrjeve, grupeve dhe shoqatave të grave;

b. të rekrutojnë për qëllimet e shërbimeve të orientimit, trajnimit dhe gjetjes së vendeve të punës persona të kualifikuar që të merren me problemet specifike të grave (psh. këshilltarë të problemeve konsullore) dhe për të marrë masat për të rritur sensibilizimin e instruktorëve;

c. të riorganizojnë shërbimet orientimit shkollor, universitar dhe profesional në mënyrë të tillë që të përpiqen për të qenë të gatshëm në interes të personave të interesuar dhe jo të mbeten në pozita pritjeje;

d. të inkurajojnë pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në kurse trajnuese duke u ofruar më shumë lehtësira arsimimi dhe trajnimit të decentralizuara dhe më të shpërndara gjerësisht;

e. të zhvillojnë masa sensibilizimi dhe informimi të tilla që t'i ofrojnë grave dhe personave që i rrethojnë imazhet e grave të angazhuara në aktivitete jo-tradicionale, veçanërisht ato që lidhen me punësimin në të ardhmen;

f. të inkurajojnë pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në arsimin më të lartë veçanërisht në fushën teknik dhe teknologjike, nëpërmjet:

- parashikimit brenda sistemit të granteve të mënyrave të kompensimit për disavantazhin e dyfishtë seksual dhe social që kanë vajzat që vijnë nga një mjedis shoqëror i paprivilegjuar;

- miratimit të masave që i mundësojnë vajzave të përfitojnë në mënyrë të barabartë nga programet e krijuara në kontekstin e lidhjeve që duhet të krijohen ndërmjet universiteteve dhe industrisë (në veçanti programi COMETT) dhe nga marrëveshjet ndër-universitare që nxisin lëvizshmërinë e studentëve (veçanërisht programi ERASMUS),

- bërjes së përpjekjeve për të orientuar vajzat drejt fushave kyçe të teknologjisë së re;

g. të inkurajojnë pjesëmarrjen më të madhe të vajzave në sistemet e ndryshme të trajnimit profesional fillestar jashtë sistemit arsimor, veçanërisht si praktikantë pune, përveç atyre që mësojnë profesione të caktuara për femrat dhe të përshtatin ose, kur është e përshtatshme, të mos aplikojnë llojet e trajnimit për gratë që nuk ofrojnë aftësim real profesional ose i orientojnë gratë në profesione të mbipopulluara;

h. të inkurajojnë gratë dhe vajzat që të krijojnë bizneset ose kooperativat e tyre duke ndërmarrë trajnim të posaçëm dhe skema trajnimit të mëtejshëm që kanë si synim veçanërisht të sigurojnë:

- trajnime në fushën e menaxhimit financiar;

- informacion në lidhje me mundësinë për të shfrytëzuar lehtësitat mbështetëse dhe financiare

i. të zhvillojnë masa që kanë si synim të nxisin pjesëmarrjen e grave në trajnime të vazhdueshme që përfshijnë:

- fushatat për sigurimin e informacionit dhe nxitjen e sensibilizimit për mundësitë që ofrohen nga një trajnim i tillë;

- masat për të inkurajuar gratë që të ndjekin kurse të tilla trajnimi, p.sh. duke përshtatur kushtet e kurseve të trajnimit (p.sh. oraret, kohëzgjatjen dhe format e trajnimit) me problemet specifike të grave dhe, kur është e përshtatshme, duke vendosur objektiva, që do të rishikohen, veçanërisht për sektorët dhe profesionet ku gratë janë të përfaqësuara ulët;

j. të sigurojnë kurse specializimi për kategori të caktuara grash, veçanërisht gratë e paprivileguara dhe ato që kthehen në punë pas një ndërprerjeje, dhe në veçanti në fazat e ndërtimit të besimit, sensibilizimit dhe para-trajnimit;

k. të hapin të gjitha llojet e trajnimit (veçanërisht ato u ofrohen të papunëve) për gratë që dëshirojnë të kthehen në punë dhe të inkurajojnë të dy palët e industrisë që të zhvillojnë projekte 'riintegrimi' që sigurojnë trajnim që mund t'i mundësojnë personave në fjalë të ri-punojnë në kompani në nivelin të cilin kanë lënë;

l. t'i mundësojë bashkëshorteve të punonjësve të vetëpunësuar, të cilat ndihmojnë në këtë aktivitet vetëpunësues dhe të përfitojnë nga mundësitë e trajnimit me të njëjtat kushte si punonjësit e vetëpunësuar;

m. të vënë në veprim masa mbështetëse, siç është sigurimi i marrëveshjeve fleksibile për mbajtjen nën kujdes të fëmijëve dhe krijimin e infrastrukturës së përshtatshme sociale, që t'i mundësojë nënave të marrin pjesë në skemat e trajnimit, përdorimin e stimujve financiarë ose asistencës në mjete monetare gjatë trajnimit;

n. të njohin aftësitë e fituara gjatë administrimit të ekonomisë shtëpiake dhe kujdesit për një familje (përfshirimi për disa elementë të caktuar të trajnimit, etj);

o. të monitorojnë progresin e grave që kanë marrë pjesë në skemat e trajnimit veçanërisht në profesionet ku gratë janë të përfaqësuara në numër të pakët.

Neni 3

Shtetet anëtare do të informojnë Komisionin brenda tre vjetëve nga data e këtij Rekomandimi për masat që janë marrë për zbatimin e tij, me qëllim që t'i lejojnë Komisionit të hartojë një raport në lidhje me këto masa.

Neni 4

Ky Rekomandim i adresohet shteteve anëtare.